



**AKTI THEMELIMIT
TE SHOQERISE "FREASHY AL" SH.P.K.**

NENI 1

Ortakët pjesëmarrës kanë vendosur të themelojnë një shoqëri tregtare që do të vepronte në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar si dhe me dispozitat e Statutit që i bashkëlidhet këtij Akti Themelimi të hartuar sipas këtij ligji.

1-Neki Zaimaj, atësia Pëllump, amësia Yllkë, shtetas Shqiptar, lindur në Sevrën, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Shkelqim Fusha", Nd. 26, H. 2, Ap. 28, Farkë, Selitë, Tiranë, lindur më 29/09/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID nr. 032576979 dhe nr. personal J70929037M.

2-Jetmira Leka, atësia Mufit, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Borsh, Sarandë dhe banuese në Himarë, me adresë Borsh Sarandë, Lukovë, Himarë, lindur më 12/04/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID nr. 036126753 dhe nr. personal H05412053K.

NENI 2

Emri i shoqërisë është "**FREASHY AL**" shpk (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar).

NENI 3

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Import -Eksport i produkteve bujqësore , fruta perime të freskëta , fruta perime të ngrira, paketim , ambalazhim i produkteve bujqësore.
- Transport i produkteve ushqimore, bujqësore .
- Import- eksport i makinerive të lehta dhe të rënda bujqësore .
- Import- eksport të pleherave kimike dhe organike bujqësore .
- Import- eksport fara dhe fidanë bujqësore .
- Prodhim bujqësor Pemetari , grumbullim i produkteve bujqësore .
- Import- eksport dhe tregëti të nën produkteve bujqësore , magazinim i produkteve e nën produkteve makinerive ambalazhimeve etj .

NENI 4

Qendra e shoqërisë është në qytetin e Tiranës . Ajo mund të hapë degë apo filiale për kryerjen e veprimtarisë së saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke respektuar ligjet e vendit në të cilat ato hapen.

Selia e shoqërisë është me adresë, kompleksi Alkin -Solued në katin përde të pallatit , Selite Tiranë , pasuria nr 100/54-N2 , ZK 3292, vol 33, faqe 158 .

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise ne para eshte 100.000 (njqind mije leke), i ndare ne 2 (dy) kuota. Kontributet e ortakeve ne Shoqeri jane shlyer teresisht ne perputhje me perqindjet e tyre takuese.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pa caktuar .

NENI 7


Viti financiar, shpërndarja e fitimit të shoqërisë, administrimi, vendimet e asamblese, punësimi, kompetencat, prishja e shoqërisë para kohe, likuidimi dhe kushtet e tjera përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 8


Akti Themelimit është përpiluar në Tirane sot më datë _____.

ORTAKET THEMELUES

NEKI ZAIMAJ

Neki Zaimaj


JETMIRA LEKA

Jetmira Leka


STATUTI
I SHOQERISE "FREASHY AL" sh.p.k

NENI 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI, BAZA LIGJORE DHE THEMELUESIT

1.1 Ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Te ndryshuar si dhe me dispozitat e Akt Themelimi te hartuar sipas ketij ligji, ortaket pjesmarres kane vendosur te themeloje nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin "**FREASHY AL**" sh.p.k .

1.2 Themeluesit e shoqerise jane :

- **Neki Zaimaj**, atësia Pëllump, amësia Yllkë, shtetas Shqiptar, lindur në Sevran, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Shkelqim Fusha", Nd.26, H.2, Ap.28, Farkë, Selitë, Tiranë, lindur më 29/09/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 032576979 dhe nr. personal J70929037M
- **Jetmira Leka**, atësia Mufit, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Borsh, Sarandë dhe banuese në Himarë, me adresë Borsh Sarande, Lukovë, Himarë, lindur më 12/04/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 036126753 dhe nr. personal H05412053K

1.3 Kjo shoqeri do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me dispozitat e ketij Statuti i cili eshte hartuar ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 , dhe Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",

NENI 2
OBJEKTI

2.1 Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Import -Eksport i produkteve bujqesore , fruta perime te freskëta , fruta perime te ngrira, paketim , ambalazhim i produkteve bujqesore.
- Transport i produkteve ushqimore, bujqesore .
- Import- eksport i makinerive te lehta dhe te renda bujqesore .
- Import- eksport te pleherave kimike dhe organike bujqesore .
- Import- eksport fara dhe fidanë bujqesore .
- Prodhim bujqesore Pemetari , grumbullim i produkteve bujqesore .
- Import- eksport dhe tregeti te nen produkteve bujqesore , magazinim i produkteve e nen produkteve makinerive ambalazhimeve etj .

NENI 3
KOHEZGJATJA

3.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pa caktuar .

NENI 4
SELIA



4.1 Selia e shoqerise eshte me adrese, kompleksi Alkin -Solued ne katin perdhe te pallatit, Selite Tirane , pasuria nr 100/54-N2 , ZK 3292, vol 33, faqe 158 . Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ne varesi te interesave dhe planeve te biznesit aktiviteti i Shoqerise mund te shtrihet edhe jashte kufijve te Shqiperise. Per kete, ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe territorin e R.SH., si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen

NENI 5

VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise ne para eshte 100.000 (njqind mije leke) , dhe eshte i ndare ne 2 (dy) kuota, nga nje ne pronesi te secilit nga ortakët themelues te Shoqerise. Vlera nominale e kuotes se secilit prej ortakeve eshte ne raport me perqindjen takuese te kontributit te secilit prej tyre ne kapitalin themeltar.

5.2 Kontributi i ortakeve themelues ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- **Ortaku Themelues: Jetmira Leka** zoteron nje kuote me perqindje takuese ne Shoqeri ne masen 70 % (shtatedhjete perqind) e kapitalit.
- **Ortaku Themelues: Neki Zaimaj** zoteron nje kuote me perqindje takuese ne Shoqeri ne masen 30 % (tridhjete perqind) e kapitalit.

5.3 Kontributet e ortakeve ne Shoqeri jane shlyer teresisht ne perputhje me perqindjet e tyre takuese.

5.4 Ne varesi te dispozitave te Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese, do kuote mund te emetohet me te drejta ose kufizime te tilla si percaktohet ne vendimin e kualifikuar te Asamblese se Pergjithshme.

5.5 Nese nje kuote zoterohet nga me shume se nje person, ata mbajne pergjegjesi bashkarisht dhe per te shlyer te gjitha thirrjet per pagese te kontributit te cilat lidhen me kete kuote. Ne marredhenie me shoqerine, keta persona trajtohen si nje ortak dhe te drejtat e tyre ushtrohen nepermjet nje perfaqesuesi te perbashket.

5.6 Bashkezoteruesit e kuotes, te cilet gezojne cilesine si nje ortak i vetem, sipas kesaj pike merren vesh ndermjet tyre per ndarjen e te drejtave e te detyrimeve, qe rrjedhin nga kjo kuote. Keto te drejta e detyrime mund te ndahen ne menyre te barabarte ose jo. Nese personat qe zoterojne nje kuote nuk arrijne nje marreveshje sipas kesaj pike, atehere zbatohen dispozitat e Kodit Civil per bashkepronesine.

NENI 6

KERKESA PER TE PAGUAR KUOTAT DHE TERHEQJA E KUOTAVE TE PAPAGUARA

6.1 Administratori ose administratoret mund t'u kerkojne ortakeve te shoqerise pjeset e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe cdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej

14 ditësh të plotë në të cilën përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shpirtërisht dhe kërkuar për kuota të zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të detyrimeve të papaguara. Personi i cili drejtohet njoftimi për pagesën e kontributeve do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij përparësisht të kalimit të mëposhëm të pronësive të kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

6.2 Zotëruarët e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidarë për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mesipër.

6.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk do të kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

6.4 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk shlyhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të pakten 14 ditë të plotë personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së shlyer se bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatëve. Njoftimi do të përmbajë vendin ku do të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast moszbatimi të tij, kuota të cilave u referohet njoftimi do të anulohet.

6.5 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendet ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuota të anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

6.6 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afatit dhe mënyrave që administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

6.7 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet çelësin e ortakut në lidhje me këtë kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotes së bashku me kamatë të llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotes.

NENI 7 CERTIFIKATAT E KUOTAVE

7.1 Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuota të zotëruar prej tij.

Shoqëria nuk është e detyruar të leshojë me shumë se një certifikatë për kuota të zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorezimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruarëve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorezim i kryer ndaj të gjithë zotëruarëve të kuotave, në përputhje me nenin 72 të Ligjit.

7.2 Emrat e zotëruarëve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotes. Certifikata nuk do të gezojë çelësin e letres me vlerë.

NENI 8 FITIMI DHE KALIMI I KUOTAVE

8.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre transferohen, fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimise;

- dhurimit;
- Dhe cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

8.2 Me perjashtim te kalimit te kuotes me ane te trashegimise, per te gjitha rastet e tjera te cituara me lart ne kete nen kerkohet miratimi i veprimit juridik te fitimit/kalimit te kuotes me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Per kete vendim nevojiten vota *pro* e ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 75% te kapitalit te Shoqerise.

8.3 Nuk lejohet transferimi dhe/ ose shitja / dhurimi i kuotes, teresisht apo pjeserisht te te tretet, per 2 vjet nga dita e paraqitjes se kerkeses per transferim nga ortaku i interesuar dhe pranimit per te blere kuoten nga ortaku/ortaket, ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti, pervec nese vendosin ndryshe ortaket qe perfaqesojne 75% te kapitalit.

NENI 8.1

SHIT-BLERJA E KUOTES - E DREJTA E PARABLERJES NGA ORTAKET

8.1.1 Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim, ne perputhje me nenin 8, vendimin e posacem te Asamblese dhe legjislacionin ne fuqi.

8.1.2 Shitja-blerja e kuotave kushtezohet nga pelqimi i organeve drejtuesve te shoqerise, ne perputhje me kete statut, duke u njohur ortakeve te drejten e parablerjes. Ortaket e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotes qe shitet. Cdo shitje e kuotes duke mos respektuar kete pike eshte e pavlefshme. Ne zbatim te ketij Statuti, procedura per shitjen/transferimin e kuotes shpjegohet ne pikat e meposhtme.

8.1.3 Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Asamblese, duke sakteluar cmimin e shitjes, i cili duhet te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet edhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e personit te trete/ blesesit potencial, cmimi i kuotes do jete i njejte dhe i pandryshueshem per ortaket e tjere, te cilet **duhet te japin nje pergjigje brenda 60 diteve nese duan apo jo te ushtrojne te drejten e parablerjes**.

8.1.4 Mosushtrimi i te drejtes se parablerjes nga ortaket, nuk cenon te drejten e tyre per te kundershtruar transferimin/ shitjen e kuotes te nje personi i trete per shkaqe te kufizimit te ketij veprimi ne ne perputhje me kete statut sipas percaktimit qe behet me poshte.

8.1.5 E drejta e parablerjes eshte proporcionale me kuotat e secilit prej ortakeve, por nese nje ortak nuk eshte i interesuar ta ushtroje kete te drejte kjo i shkon automatikisht dhe perpjesimisht pjeses ortakut/ortakeve qe kane shprehur interesin per ta ushtruar te drejten e parablerjes.

8.1.6 Ortaket, brenda 60 diteve nga dita qe ka marre njoftim per kerkesen e ortakut per te shitur kuoten e tij, i komunikojne ketij te fundit vendimin e tyre per te blere te gjitha ose pjeserisht kuoten e tij. Ortaket (ortaku) bleses te kuotes duhet te fillojne te shlyejne vleren kuotes se shitur vetem pas 2(dy) vitesh nga dita e nenshkrimit te kontrates se shit-blerjes se kuotes, duke respektuar piken 8.3 te nenit 8. Modalitetet e kryerjes se pageses se vleres se kuotes qe blihet do

te percaktohen ne kontraten e hartuar per kete qellim, pa cenuar fillimin e afatit te shlyerjes se kuotes te vendosur ne kete pike.

8.1.7 Ne rast se kuota nuk shitet brenda shoqerise, e konfirmuar pas zbatimit te procedures se percaktuar ne kete nen, atehere, brenda 60 diteve nga ky konfirmim, ajo i ofrohet personave te trete jashte shoqerise, ne perputhje me proceduren dhe kufizimin sipas pikave te meposhtme.

8.1.8 Ortaku qe shet kuoten ka detyrimin qe, perpara lidhjes se kontrates se shit-blerjes se kuotave me personin e trete, t'i paraqese Asamblese se Pergjithshme nje informacion te plote me shkrim mbi gjeneralitetet dhe te dhena te tjera te personit te trete te interesuar per blerjen e kuotes, si edhe kushtet ekonomike dhe menyren e pageses. Asambleja e Pergjithshme, nepermjet ortakut/ortakeve te tjere te Shoqerise, ka te drejte qe brenda 30 diteve nga dita e marrjes se ketij informacioni me shkrim, t'i kerkoje ortakut qe deshiron te shese kuoten te dhena shtese per personit e trete. Ortaku qe deshiron te shese kuoten ka detyrimin te jape informacion te plote per kerkesen e ortakut/ortakeve te Shoqerise . Nese Asambleja e Pergjithshme nuk shprehet me vendim brenda 30 diteve nga dita e marrjes se informacionit te plote nga ortaku qe shet kuoten, miratimi per shitjen e kuotes konsiderohet i dhene. Asambleja e Pergjithshme duhet te argumentoje vendimin per refuzimin e dhenies se miratimit te shitjes se kuotes te nje apo disa persona te trete te interesuar per blerjen e saj. Refuzimi per shitjen/transferimin e kuotes mund te ndodhe vetem nje here, par duke respektuar kufizimin e percaktuar ne kete nen.

8.1.9 Eshte e ndaluar kryerja e cdo transaksioni per transferimin (shitblerje, dhurim etj.) e kuotes personave me precedente penale.

8.1.10 Kufizimet e percaktuara per shitjen jane te zbatueshme, per aq sa pershtaten, edhe transferimit te kuotes permes dhurimit.

8.1.11 Cdo transferim i kuotes i bere ne kundersizim me kufizimet e parashikuara ne kete statut, edhe pse i kryer sipas formes se kerkuar nga ligji, eshte i pavlefshem.

NENI 9

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

9.1 Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave, dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij, pavaresisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me persona te tjere.

9.2 Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga administratoret, mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te caktuar prej tij si perfitues te kuotes.

Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje.

Nese ky person zgjedh nje person tjeter te regjistrohesh si zoterues i kuotes, ai kalon kuoten ne dobi te personit tjeter.

9.3 Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit e nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne QKB.

NENI 10 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

10.1 Asambleja me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim te pranimit te ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja me shumicen e votave te kualifikuar te ortakeve.

10.2 Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese te ortakeve, te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

NENI 11 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

11.1 Asambleja e Pergjithshme perbehet nga ortaket e Shoqerise te cilet e ushtrojne detyren e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e ketij Statuti.

11.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori/et ose ortaket ne perputhje dispozitat ligjore ne fuqi. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi, nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

11.3 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve, perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket, nese do kete te tille ne te ardhmen. Njoftimi me shkr ese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjitha ortakeve. Njoftimi duhet te behet te pakten shtate dite pune perpara mbledhjes por kjo periudhe mund te jete edhe me e shkurter Nese kete e aprovojne unanimisht ortaket .

Shoqeria nuk ka pergjegjesi per pretendimet e mos-marrjes se njoftimit nese ortaku e ka derguar njoftimin ne adresen e vene ne dispozicion nga secili prej ortakeve.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 11.1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjitha ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

11.3.1 Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut, mund t'i drejtojne administratoreve nje kerkese me shkrim, perfshire posten elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe/ose perfshirjen e ceshteve te posacme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe ceshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim. Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e

rendit te dites, ne perputhje me kete pike. Nese, ne kundershtim me piken 11.3.1 te ketij neni, asambleja e pergjithshme nuk thirret, ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, mund te ushtroje te drejtat e tij te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

11.4 Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij. Bashkezoteruesit e nje kuote ushtrojne te drejtat e votes bashkarisht, sic parashikohet ne dispozitat ligjore ne fuqi. Asnje ortak nuk mund te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme personalisht ose permes nje prokure perfaqesimi, nese perfaqeson nje kuote, kontributet e se ciles nuk jane shlyer totalisht.

11.5 Per ortaket qe nuk jane te pranishem, ky statut parashikon mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikim, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve, mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

- a. transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale;
- b. komunikimin e ndersjellte ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjeter;
- c. mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

11.6 Perdorimi i mjeteve elektronike, per t'u mundesuar ortakeve te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per te garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike, deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve.

NENI 12 VOTAT E ORTAKEVE

12.1 Kerkohet vota pro e ortakeve qe perfaqesojne io me pak se 75% te kapitalit te Shoqerise per vendimet e percaktuara specifikisht oe dispozitat eketij Statuti per ceshtje qe kane objekt:

- Ndryshimin e statutit;
- Zgjedhjen/ zevendesimin e administratorit, si edhe miratimin e prokures se perfaqesimit te Administratorit ne e mer te nje te treti perve kur parashikohet ndryshe ne kete Statut;
- Shitjen/transferimin/dhurimin e kuotes nga nje ortak;
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
- Pranimin e nje ortaku te ri ne Shoqeri;
- Blerjen e kuotes/kuotave ne shoqeri te tjera;
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- Shperndarjen e dividendit;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Pjesetimin e kuotave, anulimin dhe likuidimin e kuotes;
- Riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqerise, perfshire gjithë hapat e procedurat qe kane lidhje me keto;
- Transformimin e Shoqerise apo dhenien me qira te saj;
- Miratimin e projekteve te bashkimit dhe ndarjes dhe cdo forme bashkepunimi me te trete;
- Marrjen e kredise dhe percaktimin e kolateralit/barresimin e pronave apo dhenien e huase;
- Percaktimin e aseteve/pronave te Shoqerise per dhenien me qira per te tretet;

- Cdo vendim-marrje mbi marrëdhënie me të tretet me ndikim të drejtperdrejte ne veprimtarine e Shoqerise dhe/ ose nderhyrjet e te treteve ne Shoqeri dhe qe eshte e drejte ekskluzive e ortakeve;

12.2 Cdo vendim tjetër i Asamblese se Pergjithshme qe nuk perfshihet ne listimin e mesiperm, apo nuk bie ndesh me dispozita te tjera te ketij Statuti do te jete i vlefshem nese miratohet me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 50% te kapitalit te Shoqerise.

NENI 13

PUNIMET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

13.1 Punimet e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme , nuk mund te fillojne nese nuk eshte i pranishem forumi i parashikuar per marrjen e nje vendimi sipas kerkesave te ketij Statuti dhe legjislacionit ne fuqi. Ne cdo rast, aty ku ligji e lejon shprehimisht, dispozitat e ketij statuti prevalojne mbi ate cfare parashikojnë e dispozitat ligjore. Ortaket ose zoteruesit e prokurave te votimit mund te jene te pranishem permes mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen, qofte kjo permes lidhjes me audio ose permes lidhjes me audio dhe video. Ortaket qe marrin pjese permes mjeteve elektronike kane te drejte te votojne pasi te paraqesin PIN-in qe u eshte dhene se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

13.2 Asambleja cakton nje Kryetar per te drejtuar punimet e mbledhjes dhe nje sekretar (jo domosdoshmerisht ortak) nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

13.3 Pavaresisht nese eshte apo jo ortak, Administratorit i lejohej te marre pjese dhe te flase ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

13.4 Vendimet qe duhen aprovuar permes votimit te Asamblese merren me vote te hapur, nese, perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk eshte kerkuar ne menyre te rregullt nje votim i fshehte. Votimin e fshehte mund ta kerkoje

a. Kryetari; ose

b. Secili ortak. Kerkesa e bere nga nje person qe ka prokure votimi nga nje ortak, ka te njejten vlere sikur ta jete here nga ortaku i perfaqesuar.

13.5 Vendimet e Asamblese pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes, i cili nenshkruhet nga Kryetari, sekretari dhe ortaket pjesemarres.

NENI 14

HETIMET E POSACME

14.1 Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkesa te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

NENI 15

EMERIMI I ADMINISTRATOREVE

15.1 Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Emerimi i nenshtrohet individualisht nje vendim-marrje me shumice te kualifikuar qe kerkon votat pro te ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 75% te kapitallit te Shoqerise, i cili, nesemiratohet, ne zgjedhjen e personit/ personave te propozuar si administ rato r /e per nje periudh e

kohore 5 (pese) vjecare. Administratoret, qe perfaqesojne bashkerisht shoqerine tregtare, mund te autorizojne secilin prej tyre per kryer jen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerje n e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoqerine. *Administrator i shoqerise zgjidhet Z: Neki Zaimaj .*

15.2 Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne do kohe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

15.3 Administratori mund te heqe dore nga detyra e tij sipas menyres se parashikuar nga dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 16

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

16.1 Administratori kryen veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise te percaktuara shprehimisht nga ligji, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme dhe duke kryer detyren ne perputhje me interesat e Shoqerise dhe kufizimet e vendosura nga Asambleja.

Cdo veprim i administratorit jashte tagrave te tij te shprehura specifikisht ne ligj dhe/ose ne kete statut eshte i pavlefshem.

16.2 Administratori autorizon avokate per te mbrojtur interesat e Shoqerise, duke njoftuar per kete fakt paraprakisht Asamblene e Pergjithshme per cenimin e shkaktuar apo rrezikun qe mund t'i vije Shoqerise, si edhe te dhenat e avokatit/ avokateve te cilet mendon t'i autorizojne per kete qellim.

16.3 Administratori perfaqeson Shoqerine para te treteve vetem ne perputhje me orientimet dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve. Administratorit i takojne te gjitha kompetencat administrative te ligjshme qe nuk i jane dhene shprehimisht nga ky statut Asamblese se Pergjithshme. Administratori, ne kryerjen e detyrave te tij, duhet te kete pergjegjshmerine maksimale dhe te zbatoje detyrimin e besnikerise ndaj Shoqerise sic percaktohet dhe ne dispozitat ligjore ne fuqi.

16.4 Administratori nuk duhet te lidhe asnje marreveshje dhe nuk merr vendime per asnje ceshtje ne te cilen ka drejteperdrejte ose terthorazi , nje interes material ose jo , qe bie ose mund te bjere ndesh me interesat e shoqerise dhe qe, edhe nese ligji nuk e shpreh, specifikisht eshte kompetence ekzkluzive dhe kerkohet vendim-marrja e ortakeve themelues sipas ketij statuti.

16.5 Administratori ka te drejte te marre shperblim per punen e tij, sipas vendimit te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme te marre ne perputhje dispozitat ligjore ne fuqi.

16.6 Administratori nuk mund te Ieshoje prokure perfaqesimi per te trete, perve cfare eshte percaktuar ne piken 16.2 te ketij neni, pa marre miratimin me vendimin e posacem se Asamblese se Pergjithshme. Ne rast te leshimit te nje prokure te tille, ajo do te kete fuqi ligjore vetem ne rast se miratohet me vendimin e Asamblese se Pergjithshme , ne perputhje me vendim- marrjen e percaktuar ne nenet e ketij Statuti.

NENI 17

SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT

17.1 Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

- a. personi nuk eshte më Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit;

- b. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
- c. personi vuan ose mund te vuaj nga çrregullimet mendore;
- d. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
- e. ka munguar per me shume se 6 muaj radhazi pa lejen e administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme , me propozimin e Administratoreve, vendos ta shkarkoje nga detyra.

NENI 18 SHPERNDARJA DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

18.1 Shperndarja e Fitimeve

18.1.1 Pas permbushjes se kerkesave te dispozitave ligjore ne fuqi, Asambleja me ane te nje vendimi te marre ne perputhje me kete Statut, mund te vendose te shperndaje gjithë fitimin apo nje pjese te tij ne perputhje me te kuoten dhe perqindjen ta kuese te secilit ortak ne kapitaline Shoqerise:

18.1.2 Ortaku qe nuk ka shlyer kuoten e tij nuk ka te drejte te perfitoje nga shperndarja e fitimeve per periudhen qe ato ndahen. Kur e ka shlyer kuoten jo te vleren e plote per te cilen detyrohet, ai ka te drejte te perfitoje fitim vetem ne perpjesetim me perqindjen qe i takon per aq sa ka shlyer dhe nuk ka te drejte te kerkoje pjesen e plote te fitimit nese e shlyen te gjithë kuoten pas vendimit per shperndarjen e fitimeve .

18.2 Kapitalizimi i fitimeve

18.2.1 Me autoritetin qe i jep nje vendim i Asamblese se Pergjithshme i miratuar me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 75% te kapitalit te Shoqerise, mund te vendoset te kapitalizohen fitimet e pashperndara te Shoqerise, te cilat nuk kerkohen per te paguar dividente, preferenciale ose borxhe te tjera te pashlyera ende nga shoqeria.

NENI 19 PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Prishja dhe Likuidimi ne gjendjen e aftesise paguese

19.1 Prishja e Shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve dhe ky vendim kerkon voten pro te te ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 75% te kapitalit te Shoqerise. Ky vendim merret per shkaqe te parashikuara ne legjislacionin ne fuqi dhe ne perputhje me vullnetin dhe interesat e ortakeve. Ne rast prishje, Shoqeria vihet ne likuidim.

19.2 Ne rast te prishjes se shoqerise ne perputhje me kete statut, Asambleja e ortakeve, brenda 30 diteve nga marrja e vendimit per prishjen, duhet te caktojë nje apo me shume likuidues, te cilet duhet te paraqesin nje raport mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe afatet kohore te perfundimit te ketij procesi.

19.3 Asambleja e ortakeve do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar dhe perfundimin e likuidimit, bazuar ne raportin e likuiduesit/ likuiduesve.

19.4 Pas pageses se kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuiduesi/t do i shperndajne ortakeve gjendjen e aktivitetit te mbetur te Shoqerise proporcionalisht me vleren e kuotes se tij ne Shoqeri.

19.5 Asambleja e ortakeve, me te njejte shumice shumice te kualifikuar qe vendos prishjen dhe likuidimin e Shoqerise, mund te revokojë ne cdo moment vendimin e meparshem deri para shperndarjes se aktivitet te mbetur te Shoqerise per ortakët e saj.

NENI 20 NJOFTIMET


20.1 Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohën e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin.

20.2 Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortaku. Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit.


20.3 Ky Statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratori ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimit te nenit 4/2 te ketij Statuti.

ORTAKET THEMELUES

NEKI ZAIMAJ

Neki Zaimaj


JETMIRA LEKA

Jetmira Leka


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER EDLIRA XH. HIBRAJ**



V2021053320191069490

DATE 14/10/2021
NR REP 2476

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 14.10.2021, para meje Notere Edlira Xh. Hibraj, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Nr.5, Blv "Bajram Curri", Nr.21, Nr.42, u paraqiten personalisht:

Neki Zaimaj, atësia Pëllump, amësia Yllkë, shtetas Shqiptar, lindur në Sevran, Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Shkelqim Fusha, Nd. 26, H. 2, Ap. 28, Farkë, Tiranë, lindur më 29/09/1997, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotëjuridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032576979 dhe nr. personal J70929037M, .

Jetmira Leka, atësia Mufit, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Borsh, Sarandë dhe banues në Himarë, me adresë Borsh Sarande, Lukovë, Himarë, lindur më 12/04/1970, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotëjuridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036126753 dhe nr. personal H05412053K, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin dhe Aktin e Themelimit te shoqerise "FREASHY AL" sh.p.k.", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

EDLIRA XH. HIBRAJ